



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 46/2016

Prishtinë, më 02.2.2016, në orën 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Nebih Shatri dhe Habib Hasani - MI; Skender Sallahi - MZHE; Dardan Abazi – INDEP; Dren Ajeti – GLPS; Fjolla Uka - KDI; Florina Ejupi - BIRN; Pranvera Musa – Kosova Press, Sylejman Blaku - Kosova Sot; Liridon Llapashtica – Zëri.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoit: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.01.2016;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë -shofer;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;
5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016;
6. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa: Pasi që nuk kemi kuorum të mjaftueshëm, sepse janë vetëm 5 (pesë) anëtarë të pranishëm, në ndërkojë po presim të na bashkëngjitet edhe një 1 anëtarë i Komisionit, por vetëm mund të diskutojmë për pikat e rendit të ditës dhe jo të marrim vendim. Ai tha se pikë rendit të ditës është: Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë-shofer, ku për këtë grupi i punës e ka përgatitur raportin me amendamente. Prezantimin e këtyre amendamenteve do t'i bëjë deputeti, z.Raif Qela, të cilit i'a dha fjalën për t'i paraqitur dhe arsyetuar amendamentet.

Raif Qela tha se Projektligji për Patentë -shofer, është një projektligji mjaft vëllimor, dhe duhet të cekët se Ministra e Infrastrukturës gjatë hartimit të Projektligjit për Patentë- shofer, shihet se nuk i është përbajtur Udhëzimet Administrativ për hartimin e projektligjeve, pasi që nuk ka zbatuar teknikat për hartimin e Projektligjeve. Prandaj grupit të punës i është dashur të nxjerrë një numër të madh të amendamenteve. Ai tha së grupi i punës ka mbajtur gjithësej 6 (gjashtë) takime, si dhe ka organizuar dëgjim publik. Pothuajse në gjitha mbledhjet e grupit të punës, kanë qenë të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës për të dhenë arsyetimet dhe sqarimin e tyre. Po ashtu nga dëgjimi publik i kemi shqyrtuar propozimet dhe vërejtjet e të gjitha palëve. Ai theksoi së grupi i punës gjatë 6 (gjashtë) mbledhjeve ka hartuar gjithësej 116 amendamente, por që shumica prej këtyre amendamenteve kryesisht janë teknike, e më pak janë përbajtësore.

Sala Berisha-Shala tha se kam qenë pjesë e grupit të punës për Projektligjin për Patentë- shofer, dhe projektligji në substancë ka shumë pak ndryshime, por numrin e madhe të amendamenteve që është nxjerrë, siç e tha z. Qela, janë pothuaj shumica teknike. Çka do të thotë se Projektligji për Patentë- shofer në përbajte nuk ka ndryshuar. Ajo theksoi së koordinatori dhe stafi i Komisionit e kanë bërë një punë shumë të mirë, duke i vendosur të gjitha propozimet e palëve në një tabelë në kolona, ku grupi i punës e ka pasur shumë të lehtë të orientohet dhe të punojë, ndërsa debati në grupin e punës është zhvilluar në atë mënyrë ku janë shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha çështjet edhe disa propozime që janë dhënë nga palët dhe Shoqata e Autoshkollave janë inkoproruara në amendamente.

Raif Qela e prezentoi dhe arsyetoi secilin amendament vec e vec, dhe hodhi në diskutim dhe votim si në vijim:

Amendamenti 1, riformulon nenin 1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2, në nenin 3 është tekoniko – juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3, në nenin 3, riformulohet nënpargrafi 1.3.

Kryetari, propozoi që në vend të fjalës “lejon” të jetë fjala “mundëson”.

Komisioni përkrahu amendamentin 3 më propozimin e kryetarit.

Amendamenti 4, në nenin 3, shtohen dy nënparagrafë të rinj pas nënparagrafit 1.4.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5, në nenin 3.1.6. është tekoniko – juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6, në nenin 3, shtohet një nënparagraf i ri pas nënparagrafit 1.6.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7, në nenin 3, nënparagrafi 1.10. riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6, në nenin 3, shtohet një nënparagraf i ri pas nënparagrafit 1.11.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9, në nenin 3, fjala “komunikacion” zëvendësohet me fjalën “trafik” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit, përveç në rastet kur kjo fjalë paraqet përgatitje profesionale.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10, në nenin 3, riformulohet paragrafi 2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11, në nenin 4, parografi 2, fjala “profesionalist” zëvendësohet me “profesionist”, folja “ngas” në të gjitha zgjedhimet e saj zëvendësohet me foljen “drejtoj” në zgjedhimin përkatës, emri “ngasje” në të gjitha lakimet e tij zëvendësohen me emrin “drejtim” në lakimin përkatës, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12, në nenin 5, riformulohet paragrafi 1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12, në nenin 5, riformulohet nënparografi 1.1.1.

Kryetari kërkoi që fjalës “udhëheqësi administrativ” t’i shtohet fjala “profesional”.

Komisioni përkrahu amendamentin 12 më propozimin e kryetarit.

Amendamenti 14, në nenin 5, nënparagrafi 1.1.3 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15, në nenin 5, nënparagrafi 1.6, është tekoniko – juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16, në nenin 18, nënparagrafin 1.2; është tekniko-juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komsioni.

Amedametin 17, në nenin 9, u ndryshua nënparografi 2.1.

Kryetari kërkoj sqarime për këtë amendament dhe tha se ne kemi inxhiniera që kanë kryer për shembull shkollën e lartë të komunikacionit në Zagreb, edhe ata janë profesionista shumë të mirë dhe kanë shumë përvojë.

Raif Qela: Të gjithë punëtorët profesionistë i kemi futur në amendamente që të jenë së paku me Bachelor ose me fakultet të kryer ose Master në drejtimin e komunikacionit. Në pjesën profesionale jemi kujdesur që të ketë persona të kualifikuar.

Sala Berisha–Shala: Ne e dijmë se sistemi i shkollimit më herët ka qenë shkollë e lartë, fakultet me 5 vjet, fakultet me 4 vjet. Ministria e Arsimit e ka nxjerrë një udhëzim administrativ që i ka bërë të barasvlershme këto shkollime të mëhershme që kanë qenë. Sistemi Bachelor sipas Udhezimit administrative i njeh Bachelor me kredi 120 edhe 180, edhe sistemi me shkollë të lartë hyn në kuadër të Bachelorit, por varësisht prej kredive, kjo çështje mendoj që është e mbuluar.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18, në nenin 9, u ndryshua nënparagrafi 2.3.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20, në nenin 10, u riformulua nënparagrafi 1.5.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21, në nenin 10, paragrafit 4 i shtohet teksti “Ministria mund të autorizojë ndonjë subjekt tjetër për organizimin e trajnimit bazë për ligjëruesin profesional në autoshkollë.”

Kryetari propozoi që në vend të fjalës “tjetër” të vendoset fjalia “arsimor të akredituar”.
Komisioni përkrahu amendamentin 21 më propozimin e kryetarit.

Amendamenti 22, në nenin 11, në paragarafin 5 e fshinë fjalën “udhëheqësi profesional”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23, në nenin 12, pas paragrafit 2 e shton një paragraf të ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24, ndryshohet nenii 13.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25, në nenin 14, në nënparagrafin 1.1, mosha prej 23 vjeç zëvendësohet me “25 (njezet e pesë) vjeç”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26, në nenin 14, riformulohet nënparagrafi 1.2.

Kryetari: Kërkoj sqarim nga grupi i punës pse është zavendësuar “përgaditja shkollore e mesme” më “nivelin Bachelor” .

Raif Qela tha se grupi i punës ka ardhur në përfundim se është e nevojshme që secili përson që ka autorizime të pyetsit, të ligjëruesit profesional, si dhe në këtë rast të shofer -instruktorit duhet të kenë së pasku të përfunduara studimet në nivel Bachelor. Me këtë mendojmë se do të arrihet nivel më i lartë i dijës së kandidatit duke e marrë parasysh që përsonat e kualifikuar që përçojnë dijen te kandidati përveç një kursi apo trajnimi profesional ta kenë së paku Bachelorin të mbaruar.

Këtë propozim e përkrahu edhe deputetja **Sala Berisha- Shala**.

Nebi Shatri (përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës), tha se ne, si ministri, nuk e përkrahim këtë propozim sepse edhe në rajon, por edhe në shumicën e vendeve të BE-së “shofer- instruktori” është me shkollë të mesme, e jo me fakultet.

Komisioni u pajtua që në dispozita kalimëtare të P/Ligjit të vendoset një nen i veçantë, ku shofer- instruktorëve që i posedojnë licencat valide të ju mundësohet që këtë të drejtë ta ushtojnë deri në pensionim. Ndërsa ligjëruesve profesionalë dhe pyetësve të cilët kanë licenca valide t'i u jepet një afat pesëvjeçar që ta përfundojnë kualifikimin siç kërkohet më këtë Ligj.

Amendamenti 27, në nenin 14, nënparagrafit 1.4. i shtohet teksti si vijon: “ Përjashtim nga ky nënparagraf bën personi i cili e ka përgatitjen inxhiner i komunikacionit rrugor, ose inxhiner i makinerisë, drejtimi i automjeteve.

Kryetari propozoi që të fshihet ky amendament sepse pavarsisht përgaditjes shkollore secili përson duhet ta përfundojë trajnimin për shofer- instruktor.
Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 28, në nenin 14, nënprografi 1.6, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29, në nenini 16, fjala “të Ministrisë”, zëvendësohet “nga Ministria”.
Kryetari propozoi që kësaj fjalë t'i shtohet fjalia “nga radhët e ministrisë, shërbyes civil dhe ekspertë të jashtëm”.

Komisioni e miratoi amendamentin me propozimin e kryetarit dhe ky ndryshim vlen edhe për amendamentet e tjera të kësaj natyre.

Amendamenti 30, në nenin 16, nënparagrafi 1.2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31, në nenin 16, nënparagrafi 1.6, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32, në nenin 17, parografi 1, bëhet me ndryshimin sikurse te Amendamenti 29.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33, në nenin 17, riformulohet nënparagrafi 1.2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34, në nenin 17, riformulohet nënparagrafi 1.4.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35, në nenin 19, paragrafi 2, është tekniko-juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 36, në nenin 22, nënparagrafi 1.4, është tekniko-juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37, në nenin 23, paragrafi 2, është tekniko-juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38, në nenin 26, riformulohet nënparagrafi 1.1.

Kryetari tha se niveli i studimit “Master” është shumë i lartë të kërkohet për pësonat që mbajnë provimin teorik për patentë- shofer. Ai propozoi që të jetë “Bachelor” .

Sala Berisha- Shala tha se qëllimi pse është bërë kjo, apo pse është kërkuar që kualifikimi i zyrtarit që mbanë provimin teorik për patentë- shofer është me “Master” kemi menduar që këta duhet të jenë në nivel më të lartë, e jo vetëm ta kenë të përfunduar “Bachelorin”, po ashtu edhe vetë Ministria me propozimin e vet ka kërkuar që përgatitja shkollore të jetë superiore.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 39, në nenin 26, riformulohet nënparagrafi 1.3.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40, në nenin 26, riformulohet nënparagrafi 1.5.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41, në nenin 26, riformulon paragafin 2.

Kryetari propozoi që të fshihet ky amedendant, sepse është i panevojshum dhe e pa arsyeshëme që ne t'i përcaktojmë departamentet e ministrisë.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 42, në nenin 26, u fshi paragrafi 3.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43, në nenin 27, riformulohet paragrafi 1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44, në nenin 27, paragrafi 2, pas tekstit “brenda një viti kalendarik.” i shtohet teksti: “Caktimi i pyetësve bëhet sipas listës së plotë të pyetësve të licencuar, me radhë.”
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45, i ndryshohet titulli i neninit 28.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 46, neni 28, paragrafi 1 është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 47, neni 28, nënparagrafi 2.1.4, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 48, neni 28, nënparagrafi 2.1.5, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 49, në nenin 29, nënparagrafi 1.1. mosha “23 vjeç” zëvendësohet me “ 25 (njëzet e pesë) vjeç”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 50, në nenin 29, riformulohet nënparagrafi 1.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 51, në neni 29, nënparagrafi 1.3, mosha “3 (tri) vjet” zëvendësohet me “ 5 (pesë) vjet”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 52, në nenin 29, riformulohet nënparagrafi 1.6.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 53, në nenin 29, riformulohet nënparagrafi 1.7.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 54, në nenin 29, ndryshohet parografi 2.

Kryetari, propozoi që të fshihet ky amendament si i pa nevojshëm, sepse më i qartë është propozimi i ministrisë.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 55, neni 32, paragrafi 1, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 56, në nenin 32, riformulohet nënparagrafi 1.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 57, në nenin 32, riformulohet nënparagrafi 1.5.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 58, në nenin 33, riformulohet titulli.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 59, në nenin 33, paragrafi 1, bëhet me ndryshimin sikurse te amendamenti 29.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 60, në nenin 33, riformulohet nënparagrafi 1.5.

Nebih Shatri (përfaqësuesi i ministrisë), propozoi që aty ku thuhet “së paku 3 (tre) zyrtarë” të zëvendësohet me “2 (dy)”, sepse e kemi të pamundur teknikisht që të jenë kaqë shumë pytës në pjesën praktike.

Komisioni e përkrahu propozimin e ministrisë.

Amendamenti 61, në nenin 33, nënparagrafi 1.3. pas fjalës “trajnerit” të shtohet fjala “ose shofer instruktorit”.

Kryetari tha se duhet të fshihet ky amendament për shkak se është i pa nevojshëm dhe të mbetet propozimi i ministrisë.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Amendamenti 62, në nenin 33, riformulohet nënparagrafi 1.4.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 63, në nenin 35, paragrafi 1, afati “2 (dy) vjet” zëvendësohet me “3 (tri) vjet”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 64, në nenin 37, riformulohet paragrafi 2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 65, në nenin 38, riformulohet paragrafi 2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 66, në nenin 40, paragrafi 1, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 67, në nenin 42, riformulohet paragrafi 1.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 68, në nenin 48, paragrafi 2, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 69, në nenin 48, nënparagrafi 2.2, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 70, në nenin 49, paragrafi 1, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 71, nenit 52 i ndryshohet titulli.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 72, në nenin 52, paragrafi 1, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 73, në nenin 52, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 74, ndryshohet nenin 59.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 75, në nenin 60, paragrafi 2, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 76, në nenin 61, ndryshimi është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 77, në nenin 62, nënparagrafi 5.6.3. është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 78, në nenin 62, pas paragrafit 5, shtohet një paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 79, në nenin 64, pas paragrafit 1, shtohet një paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 80, në nenin 66, nënparagrafi 1.6 është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 81, në nenin 67, paragrafi 3, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 82, nenin 68 ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 83, riformulohet nenin 69.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 84, nenin 70 ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 85, neni 71 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 86, neni 74 i ndrrohet vendi me nenin 75 dhe ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 87, në nenin 76, riformulohet paragrafi 1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 88, në nenin 76, riformulohet paragrafi 2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 89, i riformulohet titulli nenit 79.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 90, i riformulohet titulli nenit 80.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 91, në nenin 81, në titull është tekniko- juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 92, në nenin 81, riformulohet paragrafi 1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 93, në nenin 81, riformulohet paragrafi 2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 94, në nenin 85, riformulohet nënparagrafi 1.1.1.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 95, në nenin 85, në nënparagrin 1.15 është tekniko- juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 96, neni 86 ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 97, në nenin 91, në paragrin 2 është tekniko- juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 98, në nenin 91 ndryshohet nënparagrafi 3.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 99, paragripi 1, ndryshohet afati prej “90 ditëve” në “6 (gjashtë) muaj”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 100, në nenin 94, riformulohet paragrafi 2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 101, në nenin 100, është tekniko- juridik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 102, në nenin 106 ndryshohet nënparagrafi 1.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 103, në nenin 106 ndryshohet nënparagrafi 1.5.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 104, në nenin 107, riformulohet nënparagrafi 1.1.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 105, në nenin 107 ndryshohet nënparagrafi 1.4.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 106, neni 110 paragrafi 1, bëhet me ndryshimin sikurse te amendamenti 29.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 107, në nenin 107, riformulohet nënparagrafi 1.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 108, në nenin 110, ndryshohet nënparagrafi 1.5.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 109, neni 111 paragrafi 1, bëhet me ndryshimin sikurse te amendamenti 29.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 110, në nenin 111, riformulohet nënparagrafi 1.2.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 111, në nenin 110, riformulohet paragrafi 1.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 112, në nenin 122, afati “pesë vjet” zëvëndësohet me “1 (një) vit”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendament 113, Neni 126, riformulohet si vijon:
Konflikti i ligjit
Në rast të konfliktit të dispozitave ndëshkuese të këtij ligji dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Kundërvajtje, vlejnë këto të fundit.

Raif Qela tha se këtu duhet të shtojmë një amendament të ri, sepse e kemi vërejtur se sponsorizuesi nuk ka caktuar se kush i harton pyetjet dhe përpilimin e testeve, ai propozoi: Amendament 114, pas nenit 126, shtohet një nen i ri si vijon:

Përgatitja e pyetjeve

1. Personat të cilët bëjnë përgaditjet e pyetjeve për vlerësimin e kandidatëve për shofer, shofer - instruktor, ligjerues profesional, duhet të kenë përgaditjen shkollore më të lartë se sa parashihet më këtë ligj për grupin e caktuar.
2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në testim.
3. Pyetjet e kandidatave për patentë- shoferi janë publike, kurse testët janë konfidenciale.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 114, në nenin 127, fshihet paragrafi 2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 115, neni 128, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Raif Qela tha se këtu duhet të shtojmë edhe një amendament të ri, sepse po rregullohet çështja e të licensuarave më amendamentin tjetër.

Amendament 116, në neni 129, fshihet paragrafi 2.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 117, neni 130, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 118, në nenin 132, paragrafi 1, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Kryetari e autorizoj stafin e Komisionit që t'i hartojë amendamentet sipas diskutimeve dhe t'ia dërgoj në email Raportin me amendamente të gjithë anëtarëve të Komisionit, nëse deputetët nuk kanë vëretje, në mbledhjen që do ta mbajmë sot një javë, më 9 shkurt 2016, vetëm do ta votojmë Raportin.

Mbledhja u ndërpre në orën 16:00.

Vazhdimi i mbledhjes më 9.2.2016 në orën 11:00, sala S-1.

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Nebih Shatri dhe Habib Hasani - MI; Skender Sallahi - MZHE; Dardan

Abazi – INDEP; Lekë Batalli– GLPS dhe Fjolla Uka – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Kryetari tha se po e vazhvojmë mbledhjen më të njëjtin rend dite, sepse në mbledhjen e kaluar, në mungesë kuorumi, nuk kemi mundur të marrim vendime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.1.2015;

Procesverbali i mbledhjes së datës 26.1.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë -shofer;

Kryetari tha se po e fillojmë vazhdimin e mbledhjes së datës 09.2.2016 më shqyrtimin e raportit me amendamente të Projektligjit për Patentë-shofer, pasi që në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtaur këto amendamente 1 (një) nga 1 (një), ndërsa kanë mbetur 2-3 çështje të hapura për të u rishikuar edhe një herë. Lidhur për këto çështje të hapura z. Raif Qela, në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës, i ka hartuar amendamentet dhe kërkoi ai që t'i paraqesë këto amendamente të cilat janë riformuluar. Po ashtu, tha se njësia mbështetëse e Komisionit e ka spastruar tekstin për gjitha amendamentet që janë diskutuar nga mbledhja e javës së kaluar dhe tani këto amendament kanë mbetur vetëm për t'u votuar.

Raif Qela tha që në mbledhjen e kaluar kanë mbetur disa çështje të hapura, por edhe pas rishikimit të amendamenteve të tjera ka pasur nevojë të harmonizohet teksti dhe ka raste kur disa amendamente janë shkrirë në një të vetëm, por ka edhe tjera që janë bërë të reja. Kjo është bërë më qëllim që të kemi një projektligj sa më të mirë dhe të zbatueshëm. Shtoj se në ato amendamente teknike nuk po ndalemi, por vetëm në ato çështjet përbajtësore.

Të nen 3, duhet të shtojmë edhe dy përkufizime të reja si vijon:

Amendamenti 8

Neni 3, pas nënparagrafit 1.6 shtohen dy nënparagrafë të rinj, si vijon:

1.7 “Pyetës i kandidatëve për shoferë” – ekspert i caktuar nga ministria, i cili është i licencuar që ta mbajë provimin teorik a praktik për patentë- shoferi.

1.8 “Instruktor i shoferëve” - person i autorizuar për aftësim të kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike për kategorinë përkatëse;

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Po ashtu sa i përket çështjes së kualifikimit, si p.sh. të ata individ që kanë të përfunduar “shkollën e lartë profesionale”, ne kemi bërë zgjidhje në pajtim me Rregullorën e Ministrisë së Arsimit për barazvlersheri duke i potencuar kredinë e fituar, si vijon:

Amendamenti 21

Neni 10, nënparografi 1.2 riformulohet si vijon:

1.2. t'i këtë të përfunduara studimet nga lëmi i komunikacionit, të barasvlershme me së paku 120 ECTS, sipas sistemit të Bolonjës;

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Raif Qela, Lidhur më kualifikimin e “instruktor-shoferëve” tha se grup i punës nuk ndryshon qëndrim dhe duhet të këtë kualifikim se paku Bachelor.

Kryetari propozoi që të fshihet ky kufizim dhe të mbetët sikurse në projektligj.

Sala Berisha – Shala tha se në duhet të ngrisim nivelin e kualifikimit të gjithë këtyre individëve ose zyrtarëve që merren më këtë punë, dhe shofer- instruktori duhet më qenë së paku më fakultet Bachelor.

Komisioni nuk e miratoj amendamentin 22. Sala Berisha – Shala e ndau mendimin.

Raif Qela tha se siç është rasti te amendamenti 24, ku kemi të bëjmë me “zyrtarët të cilët mbajnë provimin profesional për instrukturë të shoferëve”, po pajtohna se zyrtaret që e mbajnë provimin profesional për instruktore të shoferëve, kemi vendosur që të jenë zyrtar të emëruar nga ministri qoftë nëpunësit brenda ministrisë apo ekspertet të jashtëm, tha që jam i bindur që po të dalë jashtë institucioneve, do të jetë më problem të kontrollohen.

Kryetari tha që duhet t'i lihet kompetencë e ministrisë që ministria ta caktojë së çfarë përbërje duhet të këtë komisioni.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Sala Berisha – Shala propozi amendament të ri që të riformulohet titulli i nenit 25, si vijon: “Çmimi për licencë dhe për paraqitje të provimit”.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetës Sala Berisha – Shala.

Raif Qela propozoi që të shtohet një amendament i ri, si vijon:

Amendmenti 35

Pas neni 25, shtohet një nen i ri, si vijon:

Neni 26 Përcaktimi i procedurave për pezullim e revokim të licencës

Ministria përcakton procedurat për pezullim dhe revokim të licencës për ligjërues profesionalë dhe për instrukturë të shoferëve, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetit Raif Qela.

Kryetari propozoi që të miratohet kërkesa e Federatës së Autoshkollave që çmimi të mos caktohet nga ministria, por se paku të ketë të drejtën vetëm të një çmimi minimal.

Pas debatit Komisioni nxori amendamentet në nenin 44 dhe 46 më këtë përbajtje, si vijon:

Neni 44, paragrafi 2, pas fjalës “çmimin” shtohet fjalë “minimal”.

Neni 46, paragrafi 2, pas fjalës “çmimin” shtohet fjalë “minimal”.

Sala Berisha – Shala kërkoi që në nenet 44 dhe 46, të ulët numri i orëve të pjesëve teorike dhe praktike, sepse janë shumë orë të parapara, si dhe është një kosto e lartë për qytetarin. Propozoi që për pjesën teorike të zbritet numri i orëve nga 25 në 15 orë dhe për pjesën praktike nga 30 në 20 orë.

Pas debatit Komisioni me amendamentin 50 e ndryshoi numrin e orëve në pjesën teorike nga 30 në 20 orë, ndërsa nuk e ndryshoj fare numrin e orëve praktike. Deputetetja Sala Berisha – Shala e ndau mendimin.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

1. *Miratohet në parim Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë-shofer;*
2. *Ngarkohet stafi mbështetës i Komisionit që në bazë të debatit të hartojë amendamentet dhe t'i vendosë në tabelën në dy kolona, të njëtën t'ia përcjellë deputetëve në formë elektronike për komente dhe vërejje;*
3. *Pas vërejtjeve të mundshme të deputetëve, në mbledhjen e radhës votohet përfundimisht Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë-shofer dhe procedohet te komisionet e përherëshme sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare

Kryetari lidhur më raportin me amendamente të Projektligjit për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka hartuar disa amendamente. Kryesuese e grupit të punës është znj. Sala Berisha-Shala, të cilës ia dha fjalën për t'i paraqitur amendamentet e Projektligjit.

Sala Berisha-Shala tha që grupi i punës ka mbajtur disa mbledhje, ku kanë qenë të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pas shqyrtimit të projektligjit nen për nen, grupi i punës ka nxjerrë këto amendamentet si vijon:

Amendamenti 1, nen 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2, në nenin 2, paragrafi 2 fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3, në nenin 3, nënparagafi 1.5. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4, në nenin 3, nënparagrafi 1.7 hiqet fjala “nënkupton”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5, në nenin 3, nënparagafi 1.8. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6, në nenin 3, nënparagafi 1.10. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7, në nenin 3, nënparagafi 1.13. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8, në nenin 3, nënparagafi 1.16. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9, në nenin 3, pas nënparagafit 1.17. shtohen përkufizimet e reja.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10, në nenin 4, nënparagrafi 1.2., riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11, në nenin 4, pas nënparagrafit 1.3. shtohet një nënparagaf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12, në nenin 4, nënparagrafi 3.1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13, në nenin 4, paragrafi 4, është teknik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14, pas nenit 4, shtohet një nen i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15, në nenin 5, paragrafi 1, është teknik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16, në nenin 5, paragrafi 4, fshihet pjesa e dytë e paragafit.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17, në nenin 5, paragrafi 5, është teknik.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18, në nenin 6, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19, në nenin 6, paragrafi 3, është teknik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20, në nenin 6, paragrafi 5, është tekniko – juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21, në nenin 6, paragrafi 9, fshihet pika “iv”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22, neni 7, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23, neni 8, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24, në nenin 9, paragrafi 4, është tekniko – juridik.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25, neni 10, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26, neni 12, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27, neni 13 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28, në nenin 15, paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29, neni 16 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamentet e Projektligjit nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetari tha se Njësia mbështetëse e Komisionit e ka hartuar projektplanin e punës së Komisionit për vitin 2016, duke u bazuar në Programin Legjislativ të Qeverise për vitin 2016, po ashtu duke i vendosur dhe prioritet që i parasheh Komisioni gjatë vitit 2016. Ai theksoi se sa i përket muajit janar çështjet që kanë qenë të parapara vetëm janë shqyrtuar dhe përfunduar. Për muajin shkurt, te vizita bizneseve vendore, kërkoi që kjo vizitë të realizohet në “Klubin e Prodhuesve Vendorë”, ndërsa lidhur më vizita, nëpër Agjencitë e Pavarura, propozoi që për secilin 3 mujor të realizohet nga 1 (një) vizitë në terren te këto agjenci.

Besim Beqaj kërkoi sqarime, lidhur më vizitën në “Klubin e Prodhuesve Vendorë” se a është mekanizëm institucional apo OJQ?

Kryetari tha që është një klub i prodhuesve i themeluar zyrtarisht dhe i regjistruar nga 9 prodhues kryesorë vendorë. Kërkoi që kjo çështje të mos bëhet problematike, pasi që mund t'i vizitojmë të gjitha qoftë: Oden Ekonomike, Shoqatat e Bizneseve edhe prodhuesit e tjerë vendorë.

Besim Beqaj lidhur më këtë tha se kemi shoqata të shumta, si Asociacionin e Bizneset dhe Odën Ekonomike të Kosovës, e cila është themeluar edhe me ligj. Ai tha që për këtë është i rezervuar, pasi që ne duhet të veprojmë në mënyrë institucionale më Oden ekonomike të Kosovës, për t' u njoftuar me sfidat e problemet që i kanë prodhuesit vendorë. Propozoi që të vizitohen biznese veç e veç.

Fatmir Rexhepi propozoi që 5-6 kompani të prodhueseve vendorë të vizitohen direkt, për t'i parë për së afërmë problemet, dhe që të kemi informata nga terreni. Probleme mund të kenë degët e ndryshme të prodhueseve vendorë, siç janë industria e drurit, metalit, qumështit e tekstilit etj.

Raif Qela tha se Projektligji për Trepçën nuk është në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, dhe po shihet që nuk ka seriozitet në këtë punë. Propozoi që për këtë të kërkohet një informatë nga Qeveria sepse nuk është paraparë për këtë vit.

Kryetari propozoi që aktivitetin te “mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore, që është paraparë për çdo 3 muaj, të hiqët pasi që nuk është në kompetencën e Komisionit. Por kjo të mbetët kah muaji shtator, kur bëhet shqyrtimi i realizimit të buxhetit për vitin 2016.

Blerim Grainca kërkoi që Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburantet e ripërtëritshme të kalojë nga muaji mars në shkurt, ndërsa Projektligji për rezervat e obligueshme të naftës të kalojë prej muaji prill në mars.

Sala Berisha –Shala tha se kam pritur që në Programin Legjislativ Qeverisë për vitin 2016 të që të jetë edhe Projektligji për Trajtimin e Mbetjeve Industriale, pasi që Komisioni i Pavarur Miniera dhe Minerale, po ka problem ta trajtojë ketë çështje. Prandaj, në qoftë se Qeveria nuk e rregullon këtë çështje, atëherë propozoj që këtë nismë për hartimin e Projektligjit për Trajtimin e Mbetjeve Industriale mund ta fillojë Komisioni.

Kryetari tha sa i përket Projektligjit për Trepçën, mendoj se mund të jetë ndonjë gabim teknik, që nuk është në Programin Legislativ pér vitin 2016, pasi që, siç jeni të informuar, pér këtë çështje janë të angazhuar ekspertë të kësaj fushe dhe është duke u punuar nga Qeveria pér këtë çështje dhe ne Plan të punës do ta qesim ne qershor. Ndërsa pér Projektligjin pér Trajtimin e Mbetjeve Industriale, kërkoi sqarime se çka mund të rregullohet me anë të këtij Projektligji?

Sala Berisha –Shala tha se me anë të Projektligjit pér Trajtimin e Mbetjeve Industriale, të mirat janë në aspektin mjedisor dhe ekonomik, p.sh. Trepça prodhon gjysmë-produkte dhe këto mbetje mund të përpunohen përsëri dhe të janë në treg, ky është aspekti ekonomik, ndërsa aspekti mjedisor është shumë i madh, sepse më përpunimin këtyre mbetjeve pastrohet ambienti. Po ashtu, edhe hiri i KEK-ut dhe i minierave janë mbetje industriale që mund të përpunohen dhe që janë shitur nga KEK-u.

Besim Beqaj tha që pajtohet më propozimin e znj.Shala, pér Projektligjin pér Trajtimin e Mbetjeve Industriale, që të rregullohet kjo çështje më Ligj, pasi që deri më tanë më anë të këtyre mbetjeve industriale është bërë një keqpërdorim klandestin. Andaj, duhet të kërkohet nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që së bashku këto dy ministri të e rregullojnë këtë çështje. Ai theksoi se efektet mund të janë shumë të mëdha që e rregullojnë këtë fushë, qoftë në aspektin mjedisor dhe ekonomik.

Kryetari kërkoi që për çështjen e trajtimit të mbetjeve industriale të kërkohet një informatë nga Qeveria se si është e rregulluar kjo fushë dhe cili është plani i Qeverisë pér të rregulluar këtë çështje. Prandaj, ideja është të e shqyrtojmë dhe trajtojmë në qoftë se nuk është e rregulluar.

Raif Qela kërkoi që të shihet mundësia e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit pér pér Dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

Kryetari tha se mund të futët në plan, por njëherë të kërkohet informatë më shkrim nga ministria, KPM dhe ARKEP. Në fund kërkoi nga stafi i Komisionit që këto propozime të deputetëve të përfshihen në plan të punës.

Komisioni pas debatit njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit pér vitin 2016

6. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia pér Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamed Mustafa